TË DHËNAT TEKNIKE

ZEUS-AL

Bojra & Verniqe

VITAPLAST

BOJË PLASTIKE
PËR PËRDORIM TË BRENDSHËM

PËRSHKRIMI TEKNIK

VITAPLAST është një bojë me bazë uji, e cila përbëhet nga rezina speciale te tipit kopolimer.Është një bojë ekonomike me performancë të lartë, ka mbulueshmëri shumë të mirë dhe është rezistente ndaj larjeve dhe gërvishtjeve.
Duke qenë se ka një përqindje të ulët arome, është e përshtatshme për t'u përdorur në ambjente të brendshme. Boja nuk përbën rrezik për përdoruesin apo mjedisin.
Nuk ka përmbatje metali.
Eshtë e disponueshme në ngjyrë të bardhë dhe në një shumëllojshmëri ngjyrash të përgatitura përmes sistemit të ngjyrave **ZEUS-AL**.

CILËSITË

Karakterizohet nga nje mbulueshmëri shume e mirë, dhe është resistente ndaj pastrimit. Mund të lahet lehtë me ujë duke qenë se nuk dëmtohet nga detergjentët. Aplikohet lehtë, nuk mban erë dhe është rezistente ndaj zverdhjes. Ka bardhësi perfekte.
Produkti mund të aplikohet shumë lehtë me furçë, rul ose pistoletë.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret për aplikimet dekorative të sipërfaqeve të brendshme,në suva, allçi, beton , etj, veçanërisht në vendet ku nuk tolerohet nivel i lartë arome apo emetim i tretësave organikë gjatë aplikimit.

VOC (Përbërësit e Paqëndrueshëm Organik)
Vlera limit e BE: për këtë kategori produkti A/a (për muret e brendshme mat dhe tavanet) : 75g /l (2007) dhe 30g /l (2010).
Ky produkt përmban maksimalisht 5 g/l VOC.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com

VITAPLAST

BOJË PLASTIKE
PËR PËRDORIM TË BRENDSHËM

APLIKIMI

Sipërfaqja që dëshirojmë të lyejmë duhet të jetë e pastër, e thatë, pa praninë e shtresave të mëparshme të bojës, vajrave, yndyrnave, kripërave, etj.
Sipërfaqet e dëmtuara duhet të stukohen më parë me SPECIAL STUCCO të **ZEUS – AL**.
Sipërfaqet e reja ose sipërfaqet poroze të lyera me gëlqere ose me bojë të cilësisë së dobët, në fillim duhet të trajtohen me një dorë astar LATEX të **ZEUS – AL**, të holluar deri në masën 300% - 400% me ujë dhe pas tharjes të aplikohen dy duar me **VITAPLAST**.
Për një rifreskim të sipërfaqeve të lyera me bojë, aplikoni direkt dy duar me **VITAPLAST**.
Për të rritur efikasitetin në sipërfaqet e lyera më parë me bojë, rekomandohet që në fillim të aplikohet një dorë me astar FIXDUR, të **ZEUS – AL**, të holluar deri në masën 100% me BRUSH SOLVENT No100.
Hollimi për furçë ose rul: 5-10% me ujë sipas peshës.
Hollimi për pistoletë: 5-10% me ujë sipas peshës.
Aplikimi: Aplikoni 1-2 shtresa mbi sipërfaqen e pastruar dhe të përgatitur mirë.
Temperatura e aplikimit: 5 deri në 35°C.

TË DHËNA TEKNIKE

Ngjyra: E bardhë& ngjyrë
Rezina: PVA/VEOVA
Densiteti (e bardhë): 1.60±0.01 gr/ml (EN ISO 2811.01-02, 20°C)
Viskoziteti i produktit: 103±5 KU(ASTM D 562-05, 25°C)
Viskoziteti i magazinimit: 110±10 KU (ASTM D 562-05, 25°C)
Substanca të ngurta sipas peshës (e bardhë): 64±1% (EN ISO 3251-03)
Substanca të ngurta sipas vëllimit (e bardhë): 85±1% (ISO 3233-98)
pH: 8.5-9.0 (ISO 976-96)
Temperatura minimale e formimit të filmit: 0 ºC (ASTM D 2354)
Qëndrueshmëria në paketim: 10/10 (1 muaj, 50°C) (ASTM D 1849-03)
Shkëlqimi, në 85°: 0-5 (ELOT EN ISO 2813-99)
Koha e tharjes në 25° C:
- Tharja në sipërfaqe: 20-40 min
- Tharja në brëndësi: 45-60 orë
- Rilyerja: pas 1-2 orë

Pika e ndezjes: n.a. (ELOT EN ISO 1523-02)
Ngjitja në çimento(ndër-prerë): 0 (ELOT EN ISO 2409-95)
Mbulimi: 10 - 11 m²/lit për shtresë në sipërfaqet e përgatitura mirë.

Shënim:
- Rekomandohet që sipërfaqet e lyera të lahen 20-30 ditë pas aplikimit të bojës, në rast se është e nevojshme.
- Mbi sipërfaqe me suvatim të freskët, rekomandohet që produkti të aplikohet të pakën 30-40 ditë më pas.
- Rekomandohet shmangia e përdorimit të produktit në temperatura nën 0°C ose pak para shiut.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com